

REPUBLIKA E SËRBIS

Komuna e Medvegjës

Administrata komunale e komunës së Medvegjës

Numër: 000700555 2025 06154 004 003 000 001-3

Data : 13.05.2025.

Rru. Krala Millana 48

M e d v e g j ë

Në bazë të nenit 25. paragrafet 1, 3. dhe 4. të Ligjit për informim Publik dhe mediave („Gazeta zyrtare e Republikës së Sërbis“, nr. 92/23), neni 19. deri 23. Rregullore mbi bashkëfinancimin e projekteve për arritjen e interesit publik në lëmin e informimit publik („Gazeta zyrtare e Republikës së Sërbis“ nr.6/24 dhe 106/24), neni 79. dhe 82. Të Statutit të komunës së Medvegjës („Gazeta zyrtare e qytetit të Leskovcit“ nr. 9/2019), duke vendosur për propozimet për anëtarët e Komisionit për Konkurs për bashkëfinancimin e projekteve të prodhimit të përmbajtjeve mediatike në fushën e informimit publik në territorin e komunës së Medvegjës në vitin 2025, kryeshef i Administratës komunale të Komunës së Medvegjës miraton:

A K T V E N D I M

mbi emërimin e anëtarëve të komisionit profesional për vlerësimin e projekteve për realizimin e interesit publik në fushën e informimit publik në territorin e komunës së Medvegjës në vitin 2025

I. Emërohen anëtarët e Komisionit të profesional për vlerësimin e projekteve të paraqitura në Konkursin për bashkëfinancimin e projekteve të prodhimit të përmbajtjeve mediatike në fushën e informimit publik në territorin e komunës së Medvegjës në vitin 2025.dhe (në tekstin në vazhdim: Komisioni), dhe atë:

1. Miodrag Milkoviq, i emëruar me propozim të Qendrës për kulturë mediale dhe edukim;
2. Sllavolub Ristiq, i emëruar me propozim të Shoqatës profesionale të gazetarëve të Serbisë;
- 3.Branimir Grullovic, ekspert i mediave i cili aplikoi në mënyrë të pavarur.

Mandati i anëtarëve të Komisionit zgjat deri në përfundimin e ciklit të projektit në kuadër të Konkursit për bashkëfinancimin e Projekteve të prodhimit të përmbajtjes mediatike në fushën e informacionit publik në vitin 2025, ose deri në formimin e një Komisioni të ri për ciklin e projektit në vitin në vitin e ardhshëm.

II. Përcaktohet kompensimi për punën e anëtarëve të Komisionit për përzgjedhjen e projekteve në fushën e informimit publik, të cilat do të bashkëfinancohen me mjete nga buxheti i komunës së Medvegjës për vitin 2025, në vlerë prej 35.000,00 dinarë në shumën neto për secilin anëtar të Komisionit. Me secilin anëtar të Komisionit do të lidhet një Kontratë për kryerjen e detyrave të vlerësimit dhe propozimit të projekteve në kuadër të Konkursit të shpallur për bashkëfinancimin e projekteve të prodhimit të përmbajtjes mediatike në fushën e informimit publik, i cili do të bashkëfinancohet nga buxheti i Komunës së Medvegjës në vitin 2025.

III. Anëtarët e Komisionit nuk mund të kenë konflikt interesi ose të kryejnë një funksion publik, sipas kuptimit të rregulloreve që rregullojnë konfliktet e interesit në kryerjen e funksioneve publike. Çdo anëtar i Komisionit duhet të bëjë një deklaratë me shkrim se nuk ka konflikt interesi dhe nuk mban një detyrë publike. Nëse, gjatë punës së Komisionit, një anëtar i Komisionit pengohet të marrë pjesë më tej në punën e tij për arsye të justifikuara ose konstatohet

se ka konflikt interesi, ai ose ajo është i detyruar të informojë menjëherë personin që ka marrë këtë vendim për këtë fakt, në mënyrë që Komisioni të shpërbëhet dhe të emërohet një i ri nga radhët e kandidatëve të regjistruar.

IV. Para fillimit të punës, Komisioni do të miratojë Rregulloren e punës me të cilën do të rregullohet puna e tij në përputhje me ligjin. Anëtarët e Komisionit janë të detyruar të shqyrtojnë dhe vlerësojnë çdo projekt nëpërmjet Sistemit të unifikuar të informacionit (në tekstin e mëtejme i referuar si SUI), në përputhje me kriteret dhe fletën e pikëzimit për vlerësimin e projektit. Komisioni, bazuar në listën e renditjes, propozon shumën e mjeteve për projektet e mbështetura, bazuar në aktivitetet e planifikuara dhe vlerësimin e buxhetit të projektit. Komisioni do t'i paraqesë një propozim për shpërndarjen e mjeteve me një arsyetim Kryeshefit të Administratës komunale të komunës së Medvegjës.

Komisioni, në përputhje me ligjin dhe këtë vendim, do të kryejë edhe detyrat e mëposhtme: do të hartojë një listë renditjeje të projekteve bazuar në numrin e pikëve të marra; propozon shumën e mjeteve për projektet e mbështetura bazuar në aktivitetet e planifikuara dhe vlerësimin e buxhetit të projektit, si dhe bazuar në listën e renditjes; t'i doëzojë Kryeshefit të Administratës komunale të komunës së Medvegjës, si udhëheqës i organit kompetent që e ka shpallur konkursin, një propozim të nënshkruar për shpërndarjen e mjeteve me një shpjegim ku deklarohen arsyet për pranimin ose mospranimin e secilit projekt; Nëse është e nevojshme, do të rishqyrtojë dhe do të vendosë për projektet në një situatë kur udhëheqësi i organit publik vlerëson se propozimi i komisionit nuk është në përputhje me rregulloren ose me kriteret e publikuara në thirrjen publike.

Komisioni është i detyruar të mbajë procesverbal për punën e Komisionit dhe për të gjitha detyrat dhe veprimet e ndërmarra. Bazuar në propozimin e arsyetuar të Komisionit, kryeshefi i Administratës komunale të komunës së Medvegjës do të marrë Vendim për shpërndarjen e mjeteve në formën e një aktvendimi, jo më vonë se 90 ditë nga data e përfundimit të Konkursit, në përputhje me Ligjin.

V. Mbështetje profesionale dhe administrative-teknike në punën e Komisionit ofron Departamenti për ekonomi dhe financa, Administrata komunale e komunës së Medvegjës.

A r s y e t i m

Konkurs për bashkëfinancim të projekteve për prodhimin e përmbajtjes mediatike në lëmin e informimit publik në territorin e komunës së Medvegjës në vitin 2025, numër: 000700555 2025 06154 004 003 000 001-2 nga viti 27.02.2025. ka qenë i shpallur nga viti 28.02.2025. deri në vitin 25.03.2025. Me thirrjen publike që shpalli Konkursin, në përputhje me Ligjin për informimin publik dhe mediave, ftoi gazetarët dhe shoqatat e mediave, si dhe ekspertët e pavarur të mediave që të propozonin me shkrim anëtarët e komisionit të ekspertëve deri më vitin 25.03.2025. Me nenin 25. paragrafi 1. të Ligji për Informimin publik dhe mediave përcakton që vlerësimi i projekteve të paraqitura për konkurs kryhet nga një komision prej tre ose pesë anëtarësh. Me nenin 25. paragrafi 3. Të Ligjit për Informimin publik dhe mediave përcakton që anëtarët e Komisionit emërohen nga udhëheqësi i organit që ka shpallur konkursin, nga radhët e teoricienëve, analistëve dhe praktikuesve në fushën e medias që aplikojnë në mënyrë të pavarur, ose që aplikohen nga shoqatat gazetareske dhe mediatike, dhe që nuk janë në konflikt interesi dhe nuk kryejnë një funksion publik. Me nenin 25. paragrafi 4. të Ligji për Informacion publik dhe mediave përcakton se shumica e anëtarëve të Komisionit emërohen me propozim të shoqatave gazetarike dhe mediatike, nëse ekziston një propozim i tillë dhe nëse personat e propozuar i

plotësojnë kushtet e përcaktuara me Ligj. Me nenin 31. paragrafi 1. Ligji për Informacionin publik dhe mediave përcakton që procedura e bashkëfinancimit të projektit kryhet ekskluzivisht përmes Sistemit të unifikuar të Informacionit. Me nenin 21. paragrafi 2. Rregullorja për Bashkëfinancimin e Projekteve për arritjen e interesit publik në fushën e informimit publik përcakton që pas paraqitjes së propozimeve për anëtarë të Komisionit, shërbimi profesional i organit që ka shpallur konkursin përpilon dy lista renditjeje të kandidatëve që kanë aplikuar në përputhje me numrin e pikëve nga listat e pikëzimit (kandidatët e propozuar nga shoqatat e gazetarëve dhe mediave dhe kandidatët që aplikojnë në mënyrë të pavarur). Bazuar në listën e renditjes së mësipërme, kreu i organit që shpalli konkursin emëron Komisionin.

Përmes Sistemit të Informacionit janë pranuar gjithsej 13 aplikime, pesë kandidatë u propozuan nga shoqatat e mediave, ndërsa 8 kandidatë aplikuan si ekspertë të mediave. Aplikimet për anëtarë të Komisionit në kuadër të Konkursit të lartpërmendur për bashkëfinancim të projekteve për prodhimin e përmbajtjes mediatike në fushën e informimit publik në territorin e komunës së Medvegjës në vitin 2025 u pranuan në rregull dhe në kohë.

Për Konkursin e lartpërmendur për anëtarë të Komisionit, me propozim të shoqatave të mediave, u propozuan:

- Miodrag Milković me propozim të Qendrës për kulturë mediatike dhe edukim. Në bazë të biografisë së Formularit për aplikimim për anëtar të Komisionit (Formulari 3) dhe dokumentacionin e paraqitur përmes Sistemit të Unifikuar të Informacionit, anëtari i komisionit arriti gjithsej 91 pikë.

- Sllavolub Ristić me propozim të Shoqatës Profesionale të gazetarëve të Serbisë. Në bazë të biografisë së Formularit për aplikimim për anëtar të Komisionit (Formulari 3) dhe dokumentacionin e paraqitur përmes Sistemit të Unifikuar të Informacionit, anëtari i komisionit arriti gjithsej 90 pikë.

- Sllagjana Tasić, me propozim të Shoqatës së Radiostacionit "RAB Serbia". Në bazë të biografisë së Formularit për aplikimim për anëtar të Komisionit (Formulari 3) dhe dokumentacionin e paraqitur përmes Sistemit të Unifikuar të Informacionit, anëtari i komisionit arriti gjithsej 74 pikë.

- Ninoslav Milković, me propozim të Shoqatës të Gazetarëve të Serbisë. Në bazë të biografisë së Formularit për aplikimim për anëtar të Komisionit (Formulari 3) dhe dokumentacionin e paraqitur përmes Sistemit të Unifikuar të Informacionit, anëtari i komisionit arriti gjithsej 74 pikë.

- Predrag Filipović, me propozim të Komunitetit të Mediave të Serbisë. Në bazë të biografisë së Formularit për aplikimim për anëtar të Komisionit (Formulari 3) dhe dokumentacionin e paraqitur përmes Sistemit të Unifikuar të Informacionit, anëtari i komisionit arriti gjithsej 69 pikë.

Në Konkursin e lartpërmendur si ekspertë të mediave për anëtarë të Komisionit aplikuan:

- Branimir Grulović, në bazë të biografisë së Formularit për aplikimim për anëtar të Komisionit (Formulari 3) dhe dokumentacionin e paraqitur përmes Sistemit të Unifikuar të Informacionit, anëtari i komisionit arriti gjithsej 98 pikë.

- Nenad Perić, në bazë të biografisë së Formularit për aplikimim për anëtar të Komisionit (Formulari 3) dhe dokumentacionin e paraqitur përmes Sistemit të Unifikuar të Informacionit, që dëshmon se i plotëson kushtet për anëtar të Komisionit, ka marrë gjithsej 92 pikë.

- Lubica Zdravković –Xhonov, në bazë të biografisë së Formularit për aplikimim për anëtar të Komisionit (Formulari 3) dhe dokumentacionin e paraqitur përmes Sistemit të Unifikuar të

Informacionit, që dëshmon se i plotëson kushtet për anëtar të Komisionit, ka marrë gjithsej 86 pikë.

- Stevica Karapanxhiq, në bazë të biografisë së Formularit për aplikimim për anëtar të Komisionit (Formulari 3) dhe dokumentacionin e paraqitur përmes Sistemit të Unifikuar të Informacionit, që dëshmon se i plotëson kushtet për anëtar të Komisionit, ka marrë gjithsej 81 pikë.

- Dallibor Bubnjeviq, në bazë të biografisë së Formularit për aplikimim për anëtar të Komisionit (Formulari 3) dhe dokumentacionin e paraqitur përmes Sistemit të Unifikuar të Informacionit, që dëshmon se i plotëson kushtet për anëtar të Komisionit, ka marrë gjithsej 81 pikë.

- Dragana Kozhan, në bazë të biografisë së Formularit për aplikimim për anëtar të Komisionit (Formulari 3) dhe dokumentacionin e paraqitur përmes Sistemit të Unifikuar të Informacionit, që dëshmon se i plotëson kushtet për anëtar të Komisionit, ka marrë gjithsej 77 pikë.

- Jovan Bukovalla, në bazë të biografisë së Formularit për aplikimim për anëtar të Komisionit (Formulari 3) dhe dokumentacionin e paraqitur përmes Sistemit të Unifikuar të Informacionit, që dëshmon se i plotëson kushtet për anëtar të Komisionit, ka marrë gjithsej 73 pikë.

- dhe Teodora Pejçiq, në bazë të biografisë së Formularit për aplikimim për anëtar të Komisionit (Formulari 3) dhe dokumentacionin e paraqitur përmes Sistemit të Unifikuar të Informacionit, që dëshmon se i plotëson kushtet për anëtar të Komisionit, ka marrë gjithsej 54 pikë.

Në përputhje me atë lartpërmendur, në bazë të propozimeve të paraqitura dhe listës së renditjes së kandidatëve të regjistruar, sipas të dy kriterëve të lartpërmendura, u vendos si në dispozitiv dhe kandidatët e renditur më mirë u emëruan anëtarë të komisionit të ekspertëve për vlerësimin e projekteve për realizimin e interesit publik në fushën e informimit publik në territorin e komunës së Medvegjës në vitin 2025.

Udhëzimi mbi mjetet juridike: Ky aktvendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe kundër tij nuk lejohet ankesë, por mund të fillohet kontest administrativ me ngritjen e padisë para Gjykatës Administrative, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aktvendimit. Padia ngrihet në dy kopje, me një kopje të aktvendimit të kontestuar në origjinal ose një kopje. Tarifa e paguar për ngritjen e një kontesti administrativ është 390.00 dinarë dhe paguhet në numrin e llogarisë 840-29762845-93 në favor të tarifës gjyqësore republikane - Gjykata Administrative.

Të dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit,
- Dorëzuesve të aplikimeve,
- Departamentit për Ekonomi dhe Financa,
- në dosjet e lëndëve/arkivë.

KRYESHEF I ADMINISTRATËS KOMUNALE

Svetlana Todoroviç

